

# Statistikat e transportit\*

## Gusht 2021

**Tiranë, më 27 Shtator 2021:** Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Gusht 2021 është 430,4 mijë ton, duke u rritur 35,3 %, krahasuar me Gusht 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është rritur 27,4 %.

Në tetëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3.241,1 mijë ton, duke u rritur me 18,8 %, krahasuar me tetëmujorin e vitit 2020.

Në muajin Gusht 2021, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.652 mijë ton-kilometër, duke u ulur 18,5 %, krahasuar me Gusht 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është ulur me 39,3 %.

Në tetëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 18.289 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 12,0 %, krahasuar me tetëmujorin e vitit 2020.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër**

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Gusht 2018	314.893	1.986	165,0
Gusht 2019	380.612	4.146	175,5
Gusht 2020	318.077	2.027	136,1
<b>Mesatarja (2018-2020)</b>	<b>337.861</b>	<b>2.720</b>	<b>158,9</b>
Gusht 2021	430.362	1.652	154,1
Janar- Gusht 2020	2.728.341	16.333	1.144,9
Janar- Gusht 2021	3.241.125	18.289	1.291,1

\* Përfshin mallrat dhe postën

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Gusht 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 154,1 ton, duke u rritur 13,3 % në krahasim me Gusht 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me ajër është ulur me 3,0 %.

**Për publikim 27/09/2021**

Në tetëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 1.291,1 ton duke u rritur me 12,8 %, krahasuar me tetëmujorin e vitit 2020.

Në Gusht 2021, numri i fluturimeve të kryera është 4.106 duke u rritur 80,2 %, në krahasim me Gusht 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020, numri i fluturimeve është rritur me 48,1 %.

**Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Gusht 2018	20	2.880	23.222
Gusht 2019	20	3.160	24.817
Gusht 2020	16	2.278	14.427
<b>Mesatarja Gusht (2018-2020)</b>	19	<b>2.773</b>	<b>20.822</b>
Gusht 2021	21	4.106	22.688
Janar- Gusht 2020	16	9.782	58.343
Janar- Gusht 2021	21	15.784	75.998

\*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në Gusht 2021, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 307.634 pasagjerë. Krahasuar me Gusht 2020, ky tregues është rritur 5,0 herë. Krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është ulur me 3,4 %.

Në tetëmujorin e vitit 2021, kanë udhëtuar me linjë detare 631.447 pasagjerë, duke u rritur me 2,4 herë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në muajin Gusht 2021, transporti ajror i pasagjerëve zë 63,9 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Gusht 2021 është 561.325 pasagjerë duke u rritur 2,7 herë, krahasuar me Gusht 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është rritur me 66,6 %.

Në tetëmujorin e vitit 2021, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 1.740.445 pasagjerë duke u rritur me 90,1 %, krahasuar me tetëmujorin e vitit 2020.

**Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit**

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Gusht 2018	16.534	447.063	376.290
Gusht 2019	12.375	446.269	425.162
Gusht 2020	10.459	61.814	209.090
<b>Mesatarja Gusht (2018-2020)</b>	<b>13.123</b>	<b>318.382</b>	<b>336.847</b>
Gusht 2021	8.832	307.634	561.325
Janar- Gusht 2020	15.471	267.565	915.644
Janar- Gusht 2021	20.452	631.447	1.740.445

*Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT*

### Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Gusht 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 67,6 mld lekë dhe 46,7 % e tyre u transportua me det. Në tetëmujorin e vitit 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 702,1 mld lekë dhe 48,7 % e tyre u transportua me det.

### Eksportet e mallrave

Në Gusht 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 53,2 %, me rrugë 43,6 % dhe me ajër 1,0 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Gusht 2021 janë ulur me 20,2 %, krahasuar me Gusht 2020. Eksportet e mallrave të transportuara me rrugë në Gusht 2021 janë ulur 6,6 %, krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020.


**Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit**

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Gusht 2018	10.429	-	8.446	91	1.483
Gusht 2019	11.218	-	8.135	449	274
Gusht 2020	11.984	-	10.598	151	1.023
<b>Mesatarja (2018-2020)</b>	<b>11.210</b>	<b>0</b>	<b>9.059</b>	<b>230</b>	<b>927</b>
Gusht 2021	10.329	-	8.458	193	418
Janar-Gusht 2020	96.543	2	73.484	671	3.003
Janar-Gusht 2021	123.247	1	88.256	1.071	15.547

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT*

Në tetëmujorin e vitit 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 54,1 %, me rrugë 38,7 % dhe me ajër 0,5 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 20,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

**Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Gusht 2021**



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritjetë INSTAT

### Importet e mallrave

Në Gusht 2021 mallrat e importuara me rrugë zënë 49,4 %, me det 44,0 % dhe me ajër 3,3 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Gusht 2021 janë ulur me 20,4 %, krahasuar me Gusht 2020. Importet e mallrave të transportuara me rrugë në Gusht 2021 janë ulur me 6,5 %, krahasuar me mesataren e muajve Gusht për periudhën 2018-2020.

**Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit**


Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudh	Me rrugë	Me ajë	Të tjera
Gusht 2018	23.090	320	22.505	1.566	768
Gusht 2019	24.159	505	23.983	1.425	1.613
Gusht 2020	27.100	102	29.904	1.943	1.806
<b>Mesatarja (2018-2020)</b>	<b>24.783</b>	<b>309</b>	<b>25.464</b>	<b>1.645</b>	<b>1.396</b>
Gusht 2021	21.232	160	23.811	1.591	1.413
Janar-Gusht 2020	184.638	1.860	181.676	11.133	9.653
Janar-Gusht 2021	218.618	1.786	225.605	19.317	8.668

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Në tetëmujorin e vitit 2021, mallrat e importuara me rrugë zënë 47,6 %, me det 46,1 % dhe me ajër 4,1 %. Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 24,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>

**Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Gusht 2021**



*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

# Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet:** Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet:** Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F:** Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007):** Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash